



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Sherbime Organizimi te Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Event Sportiv te organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkolla"

"Sherbim Transporti per Pjesemarrjen ne Evente Sportive në Kuadër të Projektit 'Ekipet Sportive në Shkolla', Edicioni IV", per periudhen Mars-Qershor 2026.

Ref: Sherbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar.....	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.....	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit.....	6
9. Procesi i Vlersimit.....	6
10. Informacion nese eshte perdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Shërbime organizimi të ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në rang lokal rajonal dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit për periudhën 01.03.2026 - 30.06.2026 sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo ndeshje që do të organizohet.

Ftojme individët/kompanitë me aktivitet veprimtarie në shërbimin e kërkuar të Transportit që janë të interesuar të bashkëpunojnë për të angazhuar në aktivitetet e KOKSH.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr .	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim pa Tvsh	Vlera	Burimi i Financimit	Kohezgjatja/ Periudha
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>l</i>	<i>2</i>	$\frac{3=1}{x2}$	<i>4</i>	<i>5</i>
1	Pjesëmarrje e femijeve ne evente sportive te organizuara nga “Ekipet sportive ne shkolla”.	Realizim pjesëmarrje te fëmijëve, kordinatoreve, trajnereve dhe arbitrave sipas kalendarit të miratuar të ndeshjeve brënda qarkut dhe jashtë qarkut (për cdo qark te Shqipërisë). Femijet merren nga qyteti i tyre dhe dergohen ne vendin ku eshte caktuar ndeshja sipas kalendarit. Pra transporti i femijeve nga 1 qytet ne tjetrin dhe kthimi ne destinacionin fillestar.	Persona	10,084 femije	leke/personi		Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”.	4 - muaj sipas kalendarit te ndeshjeve te miratuara nga Ekipet Sportive,

4. Metodologjia dhe plani i punës

-Organizimi dhe Koordinimi me Kalendarin Sportiv:

Kompania fituese duhet te bashkepusoje ngushte me KOKSH dhe stafet organizuese per te



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

marre paraprakisht kalendarin e ndeshjeve dhe itineraret perkatese. Ne baze te ketij kalendarit, do te planifikohen ne kohe destinacionet, oraret dhe kapacitetet e nevojshme per çdo udhetim.

-Standardet e Sherbimit dhe Siguria:

Te gjitha automjetet e vendosura ne dispozicion duhet te jene te licencuara per transport pasagjeresh, te pajisura me rripat e sigurimit dhe mjete ndihme te shpejte. Shoferet duhet te kene eksperience dhe mjete ndihme te shpejte. Shoferet duhet te kene eksperience dhe certifikime per transport, si dhe duhet te respektojne protokollet e sigurise rrugore.

☐ **Faza Pergatitore:**

- Hartimi dhe konfirmimi i itinerareve ne bashkepunim me organizatoret.
- Identifikimi i destinacioneve dhe numrit te pjesemarresve per cdo aktivitet.
- Vendosja ne dispozicion e automjeteve sipas kerkesave logjistike te çdo zone.

☐ **Zbatimi i Transportit ne Terren:**

- Kryerja e sherbimit te transportit ne kohe dhe ne perputhje me grafikun zyrtar te ndeshjeve.
- Komunikim i vazhdueshem me organizatoret lokale per çdo ndryshim ne kohe reale.
- Monitorim i cdo udhetime dhe raportim periodik mbi ecurine e transportit.

5. Kualifikimet e nevojshme

- **Licencë active**, për transport udhëtarësh brenda Shqipërisë.
- **Eksperiencë e mëparshme**, në transport për aktivitete shkollore, sportive ose institucionale.
- **Automjete të sigurta**, me siguracion aktiv dhe rripa sigurimi për çdo pasagjer.
- **Shoferë të licencuar**, me përvojë.
- **Kapacitet për të mbuluar transportin** në të gjitha qarqet e Shqipërisë sipas kalendarit të ndeshjeve.
- **Gatishmëri për udhëtime**, edhe gjatë fundjavave apo jashtë orarit zyrtar.
- **Dokumentacion ligjor dhe fiskal i rregullt** (NIPT, QKB, Certifikata tatimore, etj.).

Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte dhe person kontakti.

6. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

7. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 25.02.2026 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

8. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Çmimi - Vlerësohet oferta më e favorshme ekonomikisht, bazuar në çmim	70%
Cilësia dhe kapaciteti – Vlerësohen kushtet dhe siguria e mjeteve të transportit, si dhe aftësia e operatorit për realizimin e shërbimit në kohë dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.	30%

9. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.